



**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**

**PAKR.nr.133/2020**

**NË EMËR TË POPULLIT**

Gjykata e Apelit e Kosovës – Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Kreshnik Radoniqi, kryetar, Xhevdet Abazi dhe Abdullah Ahmeti, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Syzana Goxhuli, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarës S.Z. - S. nga Prishtina, për shkak të veprës penale vrasje e rëndë nga neni 179 par. 1 nën par. 3 dhe 4 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me ankesat e Prokurorisë Themelore - DKR në Prishtinë, dhe mbrojtësit të akuzuarës av. S.Z., të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore - Departamenti për Krime të Rënda në Prishtinë, PKR.nr.37/2019, të datës 24.01.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur konformë dispozitës së nenit 390 par.1 të KPPK, më datë 03.07.2020, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

Me aprovimin e pjesërishtë të ankesës së mbrojtësit të akuzuarës S.Z. - S., por edhe sipas detyrës zyrtare, NDRYSHOHET Aktgjykimi i Gjykatës Themelore - DKR në Prishtinë, PKR.nr.37/2019, të datës 24.01.2020, vetëm përkitazi me cilësimin juridik të veprës penale, ashtu që, Gjykata e Apelit, veprën penale për të cilën e akuzuara S.Z. -S., është shpallur fajtores, juridikisht e cilëson si vepër penale vrasje e rëndë nga neni 179 par. 1 nën par. 3 të KPRK-së.

Ankesat e Prokurorisë Themelore - DKR në Prishtinë, dhe mbrojtësit të akuzuarës S.Z. - S., për bazat tjera ankimore refuzohen si të pabazuara, ndërsa, aktgjykimi i ankimuar për pjesën tjetër vërtetohet.

## A r s y e t i m

Gjykata Themelore - Departamenti për Krime të Rënda në Prishtinë, me aktgjykimin PKR.nr.37/2019, të datës 24.01.2020, e ka shpallur fajtores të akuzuarën S.Z.-S., për shkak të veprës penale vrasje e rëndë nga neni 179 par. 1 nën par. 3 dhe 4 të KPRK-së, dhe për këtë veprë penale e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 25 (njëzet e pesë) vjet, në të cilin dënim i ka llogaritur edhe kohën e kaluar në paraburgim nga data 05.10.2018, e gjer në plotfuqishmërinë e aktgjykimit.

Të akuzuarën e ka detyruar që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, ndërsa, në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 100 (njëqind) €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi, në afat ligjor ankesa kanë paraqitur:

Prokuroria Themelore - DKR në Prishtinë, për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarës t'i shqiptohet dënim më i ashpër me burgim se sa që ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë.

Mbrojtësi i të akuzuarës S.Z. - S., av. S.Z., për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit mbi dënimin, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë, në rigjykim dhe vendosje.

Gjykata e Apelit, seancën e kolegjit e mbajti konform dispozitës së nenit 390 par.1 të KPPK, për të cilën njoftoi Prokurorinë e Apelit, të akuzuarën, të dëmtuarën dhe mbrojtësin e saj. Në seancën e kolegjit ishin të pranishëm e akuzuara S.Z.-S. dhe mbrojtësi i saj, av. S.Z., ndërsa, edhe pse të njoftuar në mënyrë të rregullt nuk prezantuan Prokurori i Apelit e as e dëmtuara H. S.. Mbrojtësi i të akuzuarës S.Z. - S., av. S.Z., pasi më parë, bëri elaborimin e pretendimeve ankimore, theksoi se ngelë në tërësi pranë pretendimeve ankimore dhe propozimeve të bëra si në ankesë, të cilën e përkrahu edhe e akuzuara S.Z.-S..

Prokuroria e Apelit, me parashtresën PPA/I.nr.140/20, të dt. 29 04.2020, ka propozuar që ankesa e Prokurorisë Themelore - DKR në Prishtinë, të aprovohet si e bazuar dhe aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, ashtu që të akuzuarës t'i shqiptohet dënim më i lartë me burgim, kurse ankesa e mbrojtësit të akuzuarës të refuzohet si e pa bazuar.

Gjykata e Apelit, pasi shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje penalo-juridike, studioi aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPPK dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesa gjeti se:

Ankesa e mbrojtësit të akuzuarës pjesërisht është e bazuar, ndërsa, ajo e prokurorisë dhe e mbrojtësit për bazat tjera ankimore nuk janë të bazuara.

Pretendimet ankimore përkitazi me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe gjetjet e kësaj gjykate përkitazi me këto shkelje.

Mbrojtësi i të akuzuarës S.Z. - S., në ankesë pretendon se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nën par. 10 dhe 12 e lidhur me dispozitat e nenit 370 par. 6 dhe 7 të KPP-së, ngase, aktgjykimit i mungojnë arsyerat për faktet vendimtare, gjegjësisht ato që janë dhënë janë pa mbështetje në prova dhe shkresa të lëndës, pastaj, i njëjti ka mbështetje edhe në prova të papranueshme, për arsye se provat të cilat janë lexuar në seancën e shqyrtimit gjyqësor nuk janë lexuar konform dispozitave procedurale të nenit 338 të KPPK-së, pra, konform dispozitave procedurale të parapara për leximin e provave dhe shkresave tjera, ku, gjykata e shkallës së parë, pa u konsultuar fare me mbrojtësin e të akuzuarës e ka bërë leximin e deklaratave të dëshmitarëve që janë dëgjuar nga organet e ndjekjes penale në Shtetin e Francës. Pastaj, aktgjykimi i ankimuar mbështetet edhe me prova që nuk janë proceduar fare në seancën e shqyrtimit gjyqësor, sikurse që janë kamerat e sigurisë që kanë qenë të vendosura tek banesat e të akuzuarës, kamera këto, për të cilat nuk është bërë fare shikimi vizuel i tyre në seancën e shqyrtimit gjyqësor. Po ashtu, kur është fjala për prova të papranueshme gjykata e shkallës së parë, ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale edhe gjatë dëgjimit të dëshmitarit - të miturit E. S., ngase, i njëjti është marrë në pyetje në seancën e shqyrtimit gjyqësor pa respektimin e dispozitave procedurale për marrjen në pyetje të miturit, pra, i njëjti është dëgjuar pa prezencën e ekspertit të Qendrës për Punës Sociale, prandaj, gjykata e shkallës së parë, edhe në këtë drejtim ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale. Përveç, shkeljeve esenciale të cekura më lartë, aktgjykimi i ankimuar, gjegjësisht, arsyetimi i aktgjykimit është i mangët edhe përkitazi me dhënien e arsyrave për faktet vendimtare dhe atë sidomos, kur është fjala për motivin e kryerjes së veprës penale, për çka, gjykata e shkallës së parë, edhe pse e ka shpall fajtor të akuzuarën për vepër penale të vrasjes, e njëjta - pra, gjykata e shkallës së parë, nuk ka arritur të vërtetojë motivin që ka ndikuar tek e akuzuara në kryerjen e veprës penale të vrasjes, fakte këto dhe rrethana të cilit sikur të merren parasysh nga gjykata e shkallës së parë, atëherë, do të rezultonte se e akuzuara veprën penale në fjalë e ka kryer në mbrojtje të nevojshme apo edhe variantin tjetër të mundshëm vrasje e kryer nën ndikimin e afektit mendor, mirëpo, gjykata e shkallës së parë, duke mos marr fare parasysh motivin e kryerjes së veprës penale edhe nuk ka arritur të vërtetojë se a ekziston vepra penale në fjalë apo vepër tjetër penale, sikur që u cekë më lartë. Përkitazi me këtë, pra, për vërtetimin e fakteve dhe rrethanave në fjalë, gjykata e shkallës së parë, është dashur të marr parasysh, sidomos, edhe sjelljet e tani të ndjerit ndaj të dëmtuarës, por edhe familjes në përgjithësi, e në veçanti, ndaj të miturit E. S., ku edhe si pasojë e sjelljeve agresive të tani të ndjerit ndaj familjes por, edhe sjellje abuzive ndaj fëmijët të mitur të përbashkët E. S. edhe ka ardhur ditën kritike deri tek konflikti fizik në mes të akuzuarës dhe tani të ndjerit A. S., ku e akuzuara duke vepruar në mbrojtje të nevojshme e ka privuar nga jeta tani të ndjerin A. S., e në variantin më të pavolitshëm, mund të bëhet fjalë për vepër penale të kryer në afekt mendor, por, kurrësi nuk mund të flitet për vrasje të rëndë sikur që ka konstatuar gjykata e shkallës së parë. Si rezultat i shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale të cekura më lartë, pretendohet se aktgjykimi i ankimuar përkitazi me veprën penale vrasje e rëndë nga neni 179 par. 1 nën par. 3 dhe 4 të KPRK-së, duhet anuluar dhe çështja të kthehet në rivendosje.

Gjykata e Apelit, vlerëson se pretendimet e mësipërme ankimore nuk qëndrojnë e as që ka shkelje të tjera të dispozitave të procedurës penale për të cilat sipas detyrës zyrtare kujdeset kjo gjykatë, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e aktgjykimit të ankimuar.

Gjykata e Apelit, gjen se pretendimet lartë cekura ankimore janë të pabazuara, ngase, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të parapara nga neni 384 par.1 nën par. 10 dhe 12 e lidhur me nenin 370 par. 6 dhe 7, të KPPK-së, ngase, dispozitivi i aktgjykimit është i qartë, i kuptueshëm dhe konkret, në të, po ashtu, janë paraqitur të gjitha faktet dhe rrethanat që përbëjnë elementet objektive dhe subjektive të veprës penale të vrasjes së rëndë nga neni 179 par. 1 nën par. 3 të KPK-së, duke nënkuptuar edhe ato veprime inkriminuese që përbëjnë elementet cilësuese të veprës penale në fjalë, pra, të privimit nga jeta të anëtarit të familjes, vrasje, kjo, e kualifikuar e që parashihet sipas dispozitave të nenit 179 par. 1 nën par. 3 të KPK-së. Po ashtu, në arsyetimin e tij janë dhënë arsye të duhura mbi të gjitha faktet vendimtare të kësaj çështjeje penale - juridike, pra, për të gjitha pikat e aktgjykimit, duke përfshirë edhe faktet kundërtënëse, duke marrë parasysh veprimet konkrete të akuzuarës në momentin kritik, e që të njëjtat veprime inkriminuese, përveç, deklaratës së vetë të akuzuarës, gjykata e shkallës së parë, i ka vërtetuar edhe nga deklaratat e dëshmitarëve pjesëtarëve tjerë të familjes, por edhe fqinjëve, me të cilët e akuzuara dhe tani i ndjeri kanë banuar në të njëjtën ndërtesë, e duke i ndërlidhur faktet në fjalë edhe me konkludimet, gjegjësisht, të gjeturat e ekspertizës mjeko-ligjore, pra, janë dhënë arsye të mjaftueshme faktike dhe juridike, të cilat si të drejta dhe të ligjshme i aprovon edhe kjo gjykatë. Po ashtu, gjykata e shkallës së parë, vlerësimin e provave e ka bërë në pajtim me dispozitat e nenit 361 par. 2 të KPPK, kurse, për provat kontradiktore ka vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 370 par.7 të KPPK, duke paraqitur në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesash i merr si të provuara ose si të pa provuara, duke bërë vlerësimin e provave kontradiktore, pra, ajo ka bërë analizën e të gjitha provave të proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor, duke përfshirë këtu edhe ekspertizën mjeko-ligjore, pastaj, deklaratat e dëshmitarëve të dhëna në seancën e shqyrtimit gjyqësor, e të cilat edhe ashtu nuk ndryshojnë në kuptim të vërtetimit të fakteve themelore, sidomos, përkritazi me vërtetimin e fakteve dhe rrethanave se si erdhi deri tek privimi nga jeta i tani të ndjerit A. S., fakte këto dhe rrethana që nuk i konteston as vetë e akuzuar, por, që pretendon se në momentin kritik ka qenë e sulmuar nga tani i ndjeri, për çka, edhe përkritazi me këtë, gjykata e shkallës së parë, ka dhënë arsye të mjaftueshme në këtë drejtim, duke konstatuar se me asnjë provë në shkresa të lëndës, nuk vërtetohet se tani i ndjeri ta ketë sulmuar të akuzuarën, e që një pretendim i tillë nuk vërtetohet as nga vetë deklarata e të akuzuarës, ngase, nëse merren parasysh të gjitha faktet dhe rrethanat që janë të vërtetuara, deklarata e të akuzuarës e sidomos, provat materiale që janë siguruar nga vendi i ngjarjes, ku në afërsi të tani të ndjerës është gjetur sëpata-mjeti me të cilin është kryer vepra penale, pastaj, ekspertiza mjeko-ligjore ku vërtetohet se tani të ndjerit i janë shkaktuar plagë në pjesën më të ndjeshme të trupit dhe atë në qafë, ku është vërtetuar se tani i ndjeri është goditur së paku 11 herë me sëpatë, pastaj, konstatimi se në bazë të plagëve vërtetohet se ato kanë qenë kryesisht në pjesën e prapme të qafës në momentin kur i ndjeri ka qenë i shtrirë në krevat, por, edhe faktin se tek e dëmtuara nuk është evidentuar as edhe një element i vetëm dhune në trupin e saj, e përfundimisht duke marrë parasysh edhe fizionominë e tani të ndjerit por edhe të akuzuarës, atëherë, nuk mund të aprovohet mbrojtja e të akuzuarës se e njëjta ka qenë e sulmuar në momentin kritik dhe se veprën penale e ka kryer në mbrojtje të nevojshme, sikur që, nuk mund të aprovohet pretendimi i mbrojtjes se e akuzuara ka vepruar nën ndikimin e afektit mendor,

ngase, me asnjë provë në shkresa të lëndës nuk vërtetohet se nga ana e tani të ndjerit është ndërmarrë çfarëdo, veprimi në drejtim të sulmit apo të fyerjes, e që do ta vinte të akuzuarin në tronditje të fortë mendore, konkludime këto të cilat si të drejta, të ligjshme dhe objektive i aprovon edhe kjo gjykatë.

Prandaj, përveç që qasja ndaj fakteve vendimtare ka qenë e drejtë dhe e ligjshme, po ashtu, as një fakt nuk ka ngelur i pa qartë ose i pavërtetuar dhe përveç, që janë vërtetuar drejtë ato edhe janë arsyetuar në mënyrë të plotë dhe të saktë. Kështu, në rastin konkret gjykata e shkallës së parë, ka dhënë arsye të qarta për vendin, kohën, mënyrën e kryerjes së veprës penale dhe po ashtu, përkritazi me dashje dhe motivin e kryerjes së veprës penale, ku përveç, ekspertizës mjeko-ligjore, nga e cila është konstatuar se tani i ndjeri është goditur me sëpatë disa herë radhazi dhe atë së paku 11 herë, gjë që, tregon vendosmërinë e të akuzuarës për ta kryer veprën penale, në bazë të përmbajtjes së deklaratave të dëshmitarëve, pa dyshim që rezulton edhe motivi i kryerjes së veprës penale, që do të thotë, se e akuzuara për shkak të raporteve jo të mira dhe po thuajse, çdo herë konfliktuoze, e shpeshherë përveç, atyre verbale edhe fizike në mes tyre, pa dyshim që edhe ka ardhur deri tek kryerja e veprës penale, mirëpo, kjo nuk do të thotë se raportet në fjalë në mes tyre e arsyetojnë veprimin e të akuzuarës, ngase, përkritazi me raportet në fjalë, ka pasur mundësi që të kërkohet mbrojtje, e sidomos, kur është fjala për vendin ku kanë jetuar e akuzuara dhe tani i ndjeri, prandaj, pa dyshim se e akuzuara ka vepruar me dashje direkte për ta privuar nga jeta tani të ndjerin dhe atë me të vetmin motiv duke e konsideruar fajtor për raportet e tyre jo të mira familjare, prandaj edhe në këtë aspekt nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 1 nën par. 12 të KPPK-së. Po ashtu, është për t'u theksuar se gjykata e shkallës së parë, ka pasur parasysh edhe provat materiale të propozuara nga mbrojtësi i të akuzuarës për sigurimin e tyre nga Shteti i Francës, mirëpo, nga shkresat në lëndë dhe provat tjera materiale vërtetohet se edhe provat në fjalë, gjykata e shkallës së parë, i ka marr parasysh dhe atë sidomos të dhënat përkritazi me të kaluarën e të akuzuarës dhe tani të ndjerit, në kuptim të jetës bashkëshortore, pastaj, nga deklarata e dëshmitarëve - fqinjëve të akuzuarës, ka vërtetuar edhe sjelljen e të akuzuarës ndaj tani të ndjerit, sjellje këto, pra, që nuk kanë qenë të atij niveli që do të mund të konkludohej severtëm tani i ndjeri ka pasur sjellje të dhunshme, ngase, edhe për të akuzuarën, dëshmitarët në fjalë kanë vërtetuar sjelljet agresive të akuzuarës në raport me tani të ndjerin, prandaj, gjykata e shkallës së parë, me të drejtë ka refuzuar propozimin për sigurimin edhe të provave tjera materiale nga Shteti i Francës, përkritazi me faktet dhe rrethanat në fjalë. Po ashtu, gjykata e shkallës së parë, me të drejtë ka refuzuar propozimin për ekspertizë psikiatrike, ngase, në bazë të dokumentacionit të ofruar nga Shteti i Francës, nuk rezulton se e njëjta ka qenë nën ndikimin e sjelljeve jo normale e që do ta vënin në dyshim gjendjen e aftësisë mendore të akuzuarës, sidomos, kur dihet se e njëjta, pasi që e ka kryer veprën penale krejtësisht në mënyrë të qetë i merr fëmijët e saj dhe niset për në Kosovë, ku pasi zbulohet vepra penale në fjalë, e akuzuara arrestohet nga policia në Kosovë, ndërsa, sa i përket pretendimit se aktgjykimi i ankimuar bazohet në prova të papranueshme, sidomos, në deklaratën e të miturit E. S., të njëjtat janë të pabazuara, ngase, sipas procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor rezulton se i njëjti-pra, i mituri E. S., është dëgjuar në prezencën e punëtorëve social të QPS-së, në Prishtinë, ndërsa, provat e siguruar nga Shteti i Francës, janë prova të cilat janë proceduar konform dispozitave ligjore të Shtetit të Francës, që do të thotë se sipas dispozitave të Ligjit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar të Kosovës, të gjitha provat që sigurohen nga Shteti tjetër duhet të jenë të proceduara konform dispozitave të Ligjit

të atij Shteti, gjë që, edhe ka ndodhur në rastin konkret, sikur që nuk qëndron pretendimi ankimor, se leximi i provave materiale por edhe deklaratave të dëshmitarëve, nuk është bërë konform dispozitave ligjore të KPPK-së, të parapara për leximin e shkresave dhe provave tjera, ngase, nga procesverbali i shqyrtimit gjyqësor vërtetohet se prokuroria dhe mbrojtësi i të akuzuarit nuk kanë kundërshtuar leximin e provave në fjalë, mirëpo, edhe sikur të ndodhte një gjë e tillë, duke pasur parasysh se është fjala për provat që janë siguruar nga Shteti i Francës, atëherë, gjykata e shkallës së parë, ka pasur të drejtë ta bëjë leximin e tyre edhe në kuptim të dispozitave të nenit 388 par. 1 nën par. 1 të KPPK-së, ku lejohet mundësia e leximit të deklaratave të dëshmitarëve dhe ekspertëve, prezenca e të cilëve është e pamundur të sigurohet. Po ashtu, nuk qëndron pretendimi ankimor përkitazi me shikimin e video incizimeve të kamerave të sigurisë të shtëpisë së të akuzuarës, me pretendim se të njëjtat nuk janë shikuar fare, ngase, nga procesverbali i shqyrtimit gjyqësor rezulton se edhe në këtë drejtim palët nuk kanë pasur vërejtje që do të thotë se gjykata ka vepruar konform dispozitave të parapara për shikimin e video incizimeve, për çka, palët kanë mundur të bëjnë vërejtje menjëherë në procesverbal, e pastaj, gjykata të veprojë sipas kërkesës së palëve, pra, në këtë aspekt nuk ka shkelje të dispozitave të procedurës penale, sikur që pretendon mbrojtësi i të akuzuarës, e që do të kushtëzonin anulimin e aktgjykimit të ankimuar, sikur që pretendon mbrojtësi i të akuzuarës S.Z.-S..

Pretendimet ankimore përkitazi me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkelje të ligjit penal si dhe gjetjet e gjykatës përkitazi me shkeljet në fjalë.

Përkitazi me bazën ankimore vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike, në ankesë në esencë kontestohet vetëm mënyra e vlerësimit të provave të proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor nga ana e gjykatës së shkallës së parë, si dhe konkludimet të cilat ajo i ka nxjerrë në bazë të provave të proceduara. Pretendohet se provat janë vlerësuar në mënyrë të gabuar dhe të njëanshme, prandaj edhe përfundimet kanë pasuar të gabuara, pa mbështetje në prova, për çka të akuzuarën, është dashur ta lirojë nga akuza, ngase, e njëjta ka vepruar në mbrojtje të nevojshme apo eventualisht, ta shpall fajtor për veprën penale të vrasjes në afekt mendor, e jo sikur që është vepruar nga gjykata e shkallës së parë. Kjo për arsye se gjithherë sipas pretendimeve ankimore, gjykata e shkallës së parë, edhe përkundër dëgjimit të shumë dëshmitarëve, vetë të akuzuarës, provave materiale në shkresat e lëndës nga vendi i ngjarjes, përsëri nuk ka arritur ta vërtetojë gjendjen faktike, ngase, duke pasur parasysh gjendjen e të akuzuarës në momentin kritik e cila ka qenë e sulmuar nga tani i ndjeri A. S., atëherë, mu sjellja e tani të ndjerit ndaj të akuzuarës ka qenë arsyeja kryesore që e akuzuara duke e ndjerë veten të rrezikuar, e njëjta ka vepruar në mbrojtje të nevojshme apo eventualisht edhe nën ndikimin e afektit mendor, por kurrsesi të ketë kryer vrasje të rëndë sikur që ka konstatuar gjykata e shkallës së parë, për çka pretendohet se me këtë është bërë edhe shkelje e ligjit penal në dëm të akuzuarës, kur është shpallur fajtor për veprën penale si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Gjykata e Apelit, konstaton se pretendimet e larë cekura ankimore nuk qëndrojnë, ngase, në këtë çështje penalo - juridike nuk janë kontestuese rrethanat përkitazi me vendin ku është kryer vepra penale, veprimet e ndërmarra nga e akuzuara, vendi ku janë shkaktuar lëndimet trupore të tani të ndjerit, e si rezultat i të cilave ka ardhur edhe te vdekja e tani të ndjerit, por kontestuese ngelin në rastin konkret rrethanat përkitazi me elementin subjektiv të veprës penale, pra, lidhur me dashjen e të akuzuarës, duke potencuar se e akuzuara, nuk ka

pasur dashje gjegjësisht qëllimin që të privojë nga jeta tani të ndjerin, por se e njëjta ka ndërmarrë veprimet inkriminuese pa fajin e saj, ngase, pasi është sulmuar nga tani i ndjeri dhe e njëjta për ta zmbursur sulmin e atë çastshëm e godet me sëpatë tani të ndjerin dhe si rezultat i sjelljes së tani të ndjerit vije edhe deri te sjellja e të akuzuarës në gjendje të afektit mendor dhe pastaj, e njëjta nën ndikimin e afektit mendor i ndërmerr veprimet inkriminuese në drejtim të privimit nga jeta të tani të ndjerit e që, sipas pretendimeve ankimore e akuzuara kryen vepër penale të vrasjes në afekt mendor, por, kurrësi vrasje të rëndë nga neni 179 par. 1 nën par. 3 e 4 të KPK-së, për të cilën edhe e ka shpallur fajtoreshë gjykata e shkallës së parë, e çka, pra, gjithëherë sipas pretendimeve ankimore, gjykata e shkallës së parë, ka bërë edhe shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarës S.Z.-S..

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, pretendimet ankimore përkitazi me këtë bazë ankimore, po ashtu nuk qëndrojnë, ngase, në bazë të provave të prezantuara në seancën e shqyrtimit gjyqësor, por edhe vetë mbrojtjes së të akuzuarës, vërtetohet se ditën kritike e akuzuara, e kishte goditur tani të ndjerin me sëpatë dhe atë së paku 11 herë, kryesisht në pjesën e kokës në qafë, ku pastaj, i ndjeri ka mbetur i vdekur në vendin e ngjarjes, gjegjësisht, koka kishte mbetur e lidhur për trupi të tani të ndjerit vetëm përmes një pjese të lëkurës, ku pastaj, e akuzuara i merr fëmijët e saj dhe me automjet largohet nga vendi i ngjarjes, duke ikur nga shteti i Francës për në Kosovë, faktet këto dhe rrethana, që gjykata e shkallës së parë, i ka vërtetuar edhe përmes provave materiale në shkresa të lëndës, si ekspertiza mjeko-ligjore, raporti i vendit të ngjarjes, foto dokumentacioni, video incizimet e kamerave të sigurisë, e që të njëjtat nuk i ka kontestuar as e akuzuara në mbrojtjen e saj, vetëm se duke pretenduar se e njëjta ka vepruar në mbrojtje të nevojshme, ndërsa, sipas pretendimit të mbrojtësit, e njëjta, pra, e akuzuara, ka mundur të ketë vepruar edhe në gjendje të afektit mendor.

Ndërsa, përkitazi me faktet dhe rrethanat në fjalë, pra, kontestuese se, a veprimi e akuzuara në mbrojtje të nevojshme apo nën ndikimin e tronditjes së fortë mendore, të vënë pa fajin e saj, gjykata e shkallës së parë, përkitazi me faktet dhe rrethanat në fjalë, përveç mbrojtjes së të akuzuarës, të cilën e ka vlerësuar si të pabazë dhe të pa argumentuar, ka marrë parasysh edhe provat materiale në shkresa të lëndës, gjegjësisht, raporti nga vendi i ngjarjes dhe ekspertizën mjeko-ligjore, ku ka vërtetuar se e akuzuara e ka goditur me sëpatë në kokë tani të ndjerin dhe atë së paku 11 herë radhazi, ku pastaj, të ndjerit koka i ishte prerë krejtësisht nga pjesa tjetër e trupit, gjegjësisht ishte mbetur e lidhur me trupin përmes një pjese të lëkurës, se në vendin e ngjarjes ishte gjetur edhe sëpata e sidomos, ka marrë parasysh edhe vendin ku është goditur tani i ndjeri - pra, në qafë, dhe atë në pjesën e prapme, dhe sipas ekspertizës mjeko-ligjore, në momentin kritik i ndjeri ka qenë i shtrirë në krevat, në pozitën barkas, pra, në shpinë e kthyer nga e akuzuara, që do të thotë se nuk ka pasur mundësi logjike që i ndjeri të ketë ndërmarrë çfarëdo veprimi fizik në drejtim të akuzuarës, që do të thotë se eliminohet mundësia që tani i ndjeri ta ketë sulmuar të akuzuarën, pastaj, duke i marrë parasysh edhe raportet e tyre jo të mira bashkëshortore, pothuajse gjithëherë konfliktuoze, atëherë, pa dyshim që e akuzuara me dashje ka ndërmarrë veprimet në drejtim të kryerjes së veprës penale të vrasjes nga neni 179 par. 1 nën par. 3 të KPK-së.

Prandaj, duke i pasur parasysh rrethanat e rastit konkret, në të cilat është zhvilluar ngjarja kritike, se e akuzuara me sëpatë e ka goditur tani të ndjerin disa herë radhazi dhe atë së paku 11 herë, pa kurrfarë reagimi fizik apo verbal të tani të ndjerit, pastaj, duke marrë parasysh edhe vetë deklaratën e të akuzuarës por edhe dëshmitarëve se e njëjta me tani të

ndjerin ka pasur raporte jo të mira bashkëshortore, ku përkitazi me këtë ka pasur edhe procedura para gjykatave në Shtetin e Francës, rezulton se tek e akuzuara qëndron elementi subjektiv i veprës penale, për të cilat është shpallur fajtoreshë, pra, qëndron fakti se e njëjta veprimet konkrete inkriminuese i ka ndërmarrë me dashje dhe atë me dashje direkte - pra, për ta privuar nga jeta tani të ndjerin dhe me të vetmin motiv për shkak të raporteve jo të mira bashkëshortore. Kështu, që arsyet më të detajuara të dhëna në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, në tërësi si të drejta dhe të ligjshme i aprovon edhe kjo gjykatë, ngase të njëjtat kanë mbështetje në provat e prezantuara në seancën e shqyrtimit gjyqësor, për çka po ashtu aktgjykimi i ankimuar përmban edhe arsye të mjaftueshme mbi të gjitha faktet vendimtare dhe në bazë të një gjendje të tillë faktike të vërtetuar rezulton se në mënyrë të drejtë janë aplikuar edhe dispozitat e ligjit penal, duke përfshirë këtu edhe elementin kualifikues të veprës penale sipas par. 4 të nenit 179 par. 1 të KPK-së, për çka, më në detaje, për këtë, do të flitet tek elaborimi i bazës ankimore shkelje e ligjit penal.

Pretendimet ankimore në drejtim të shkeljes së Ligjit Penal, në dëm të akuzuarës, kjo gjykatë i vlerëson të bazuara, kur është fjala për formën kualifikuese të veprës penale të vrasjes së rëndë të paraparë sipas par. 4 të nenit 179 të KPK-së, ngase, në rastin konkret është shkelur Ligji Penal në dëm të akuzuarës, kur gjykata të akuzuarën e ka shpallur fajtoreshë për veprën penale vrasje e rëndë nga neni 179 par. 1 nën par. 3 e 4 të KPK-së, pra, për formën cilësuese të veprës penale të paraparë sipas par. 1 nën par. 4 të nenit 179 të KPK-së, ngase, gjykata e shkallës së parë, faktet vendimtare, përkitazi me gjendjen faktike, i ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë dhe duke pasur parasysh gjendjen faktike të vërtetuar në rastin konkret me zbatimin e drejtë të ligjit është dashur të merret aktgjykim me cilësim juridik të veprës penale, sipas nenit 179 par. 1 nën par. 3 të KPK-së, për çka, edhe vendosi që aktgjykimi i shkallës së parë, të ndryshohet ashtu që veprimet inkriminuese të akuzuarës, të përshkruara si në dispozitiv të aktgjykimit të shkallës së parë, t'i cilësojë si vepër penale vrasje e rëndë nga neni 179 par. 1 nën par. 3 të KPK-së, kjo, për arsye se nën par. 4 i dispozitës në fjalë, përfshin formën kualifikuese të veprës penale të vrasjes, kur vrasja kryhet me elemente të mizorisë dhe të dinakërisë, për çka, gjykata e shkallës së parë, me të drejtë ka eliminuar mizorinë, për çka, edhe ka dhënë vlerësimin e saj, e që e aprovon edhe kjo gjykatë, mirëpo, kur është fjala për dinakërinë, duke pasur parasysh së pari dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar, ku në përshkrimin e figurës së veprës penale nuk cekët asnjë veprim i vetëm inkriminues i të akuzuarës që ka të bëjë me dinakëri, ndërsa, në arsyetim është konstatuar se e akuzuara ka kryer veprën penale gjatë kohës kur po flinte tani i ndjeri, mirëpo, nga provat dhe shkresat tjera në lëndë nuk vërtetohet një gjë e tillë, atëherë, kjo gjykatë e eliminoi formën kualifikuese të veprës penale të vrasjes së rëndë të paraparë sipas nën par. 4 dhe në këtë drejtim edhe aktgjykimin e ankimuar e ndryshoi si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Pretendimet ankimore përkitazi me sanksionin penal dhe gjetjet e gjykatës.

Duke e shqyrtuar çështjen përkitazi me vendimin për dënimin, Gjykata e Apelit, gjen se pretendimet ankimore të Prokurorisë, si dhe ato të mbrojtësit të akuzuarës, nuk janë të bazuara.



Në ankesën e prokurorisë, përkitazi me këtë bazë ankimore, theksohet se gjykata e shkallës së parë, me rastin e marrjes së vendimit mbi dënim nuk ka vepruar drejtë kur të akuzuarës për veprën penale që i vihet në barrë i ka shqiptuar dënim shumë të butë, për çka, e njëjta konstaton se nuk ka gjetur rrethana lehtësuese, ndërsa, rrethana rënduese ka vlerësuar mënyrën e kryerjes së veprës penale, përkatësisht, këmbëngulësinë dhe vendosshmërinë për kryerjen e veprës penale, sjelljen e të akuzuarës pas kryerjes së veprës penale, e cila krejt në qetësi është larguar nga vendi i ngjarjes, duke manifestuar kështu, mungesë të plotë të ndjeshmërisë ndaj të ndjerit A., në kohën e privimit të tij nga jeta, pastaj, i njëjti ka qenë baba i 2 fëmijëve por edhe dhimbja që i është shkaktuar familjes së të ndjerit e në veçanti prindërve të tij, andaj, konsiderojë se në prezencën e këtyre rrethanave, gjykata e shkallës së parë, është dashur t'i shqiptojë të akuzuarës dënim më të ashpër se sa që ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë. Ndërsa, mbrojtësi i të akuzuarës, në ankesë përkitazi me këtë bazë ankimore konstaton se dënimi i shqiptuar të akuzuarës është shumë i rëndë, sidomos kur dihet se nuk mund të bëhet fjalë për vepër penale të vrasjes së rëndë, pastaj, më tutje shton se sikur gjykata ta kryente punën me përkushtim profesional do ta analizonte rastin dhe atë sidomos, jetën e të akuzuarës nga fillimi i lidhjes me tani të ndjerin dhe të kishte parasysh përpjekjet e pafundme që kishte bërë për ndërtimin e familjes dhe atë për një jetë të mirë bashkëshortore por edhe përkushtimin e fëmijëve të tyre, por, edhe faktin se e akuzuara nuk ka qenë person problematik sikur që u përpoqën disa nga dëshmitarët ta paraqesin, atëherë, me siguri që edhe dënimi ndaj të akuzuarës do të ishte më i butë, për çka, i propozon gjykatës pasi që aktgjykimi është i kundërligjshëm, atëherë, edhe vendimi për dënim është i kundërligjshëm.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, në ankesat e paraqitura nuk prezantohet ndonjë rrethanë tjetër rënduese apo lehtësuese, të cilat kishin me pasur ndikim të drejtpërdrejtë në lartësinë e dënimit, ngase, në ankesën e prokurorisë më shumë bëhet vërejtje përkitazi me vlerësimin e rrethanave ekzistuese rënduese nga gjykata e shkallës së parë, ndërsa, rrethana tjera që do të ndikonin në ashpërsimin e dënimit nuk cekën, por vetëm përsëriten rrethanat e njëjta të cilat edhe gjykata e shkallës së parë, i ka pasur parasysh gjatë vendosjes, ndërsa, mbrojtësi i të akuzuarës, po ashtu, nuk potencon rrethana konkrete lehtësuese, por, vetëm bën përpjekje të arsyetojë veprimet e të akuzuarës, e që më shumë kanë të bëjnë me elementet e veprës penale, për të cilën e akuzuara edhe është shpallur fajtores, se sa me rrethana lehtësuese konkrete.

Prandaj, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë, drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka konstatuar dhe vlerësuar të gjitha rrethanat që ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit siç parasheh dispozita e nenit 73 të KPK-së, ngase, duke pasur parasysh të gjitha këto rrethana, rrethanat e cekura në aktgjykimin e ankimuar, rrethanat e rastit konkret, mënyrën si është zhvilluar ngjarja ditën kritike, pastaj, shkaktimin e pasojës së ndaluar, vendoseshmërinë e treguar nga e akuzuara, duke e goditur tani të ndjerin së paku 11 herë radhazi dhe atë duke ia prerë kokën dhe atë pothuajse krejtësisht të ndarë nga trupi, pastaj, sjelljen e të akuzuarës pas kryerjes së veprës penale ku e akuzuara i merr fëmijët e saj krejt në mënyrë të qetë dhe arratiset për në Kosovë, duke e lënë kufomën në vend të ngjarjes disa ditë derisa këtë e kanë zbuluar fqinjët, kuptohet nga kundërmimi i kufomës, rezulton se dënimi i shqiptuar të akuzuarës është i drejtë dhe i ligjshëm dhe në harmoni me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarës, po ashtu i njëjti është në funksion të preventivës gjenerale, por edhe asaj

individuale dhe se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë në dispozitat e nenit 41 të KPK-së.

Nga sa u tha më lartë, e konform dispozitës së nenit 401 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PAKR.nr.133/2020, me dt. 03.07.2020**

Procesmbajtëse,  
Syzana Goxhuli

Anëtarët e kolegjit,

Kryetar i kolegjit,  
Kreshnik Radoniqi

1. Xhevdet Abazi
2. Abdullah Ahmeti